




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



Qershor, 2021

PËRMBAJTJA

Shkurtesat e përdorura.....	2
Lista e figurave.....	3
Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
1 Të dhënat e përgjithshme.....	6
2 Gjetjet kryesore.....	7
2.1 Ndikimi i COVID - 19 në prodhim.....	7
2.2 Ndikimi i COVID - 19 në qarkullim.....	9
2.3 Ndikimi i COVID - 19 në eksport.....	11
2.4 Ndikimi i COVID - 19 në import (furnizim).....	13
2.5 Ndikimi i COVID - 19 në punësim.....	15
2.6 Vlerësimi i masave të ndërmarra nga qeveria.....	17
2.7 Sfidat e bizneseve para dhe gjatë pandemisë COVID-19.....	18
3 Rekomandimet.....	21
4 Referencat.....	22
5 Aneks 1	
Pyetjet e përgjithshme të adresuara gjatë intervistave.....	23

Shkurtesat e përdorura

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	-	Banka Botërore
BE	-	Bashkimi Evropian
BPV	-	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
DI	-	Departamenti i Industrisë
DPI	-	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Industriale
MINT	-	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
UNDP	-	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Lista e figurave

Figura 1. Ndikimi i COVID-19 në prodhim.....	8
Figura 2. Ndikimi i COVID-19 në prodhim, sipas sektorëve.....	8
Figura 3. Ndikimi i COVID-19 në qarkullim.....	10
Figura 4. Ndikimi i COVID-19 në qarkullim, sipas sektorëve.....	10
Figura 5. Ndërmarrjet e intervistuar, eksportuese dhe jo-eksportuese.....	11
Figura 6. Ndikimi i COVID-19 në eksport.....	12
Figura 7. Ndikimi i COVID – 19 në eksport, sipas sektorëve.....	13
Figura 8. Ndërmarrjet e intervistuar, importuese dhe jo-importuese.....	14
Figura 9. Ndikimi i COVID-19 në import.....	14
Figura 10. Ndikimi i COVID – 19 në import, sipas sektorëve.....	15
Figura 11. Ndikimi i COVID-19 në punësim.....	16
Figura 12. Ndikimi i COVID – 19 në punësim, sipas sektorëve.....	17
Figura 13. Vlerësimi i masave të ndërmara nga Qeveria.....	18

HYRJE

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, konkretisht Departamenti i Industrisë/Divizioni për Politika Industriale, ka kryer 77 vizita, intervista gjysmë të strukturuar në ndërmarrjet e industrisë përpunuese në Kosovë.

Duke u bazuar në raportet e Bankës Botërore, UNDP, Odat e bizneseve në Kosovë dhe raportet tjera të cilat tregojnë se Covid-19, përveç shëndetit publik ka shkaktuar edhe një tronditje të madhe ekonomike, DPI ka hulumtuar ndikimin e tij në Sektorët e Industrisë përpunuese.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të informohemi me ndikimin e Covid-19, gjatë vitit 2020, identifikimin e sfidave tjera dhe ndikimin e tyre në performancën e ndërmarrjeve të industrisë përpunuese.

Përmes këtij hulumtimi, do të identifikohen nevojat kryesore dhe do të hartohen politika të cilat do t'i përgjigjen nevojave të ndërmarrjeve të industrisë përpunuese.

Raporti synon të trajton sektorin e industrisë përpunuese duke u bazuar në indikatorët e mëposhtëm:

- Ndikimi i pandemisë në prodhim;
- Ndikimi i pandemisë në punësim;
- Ndikimi i pandemisë në eksport;
- Ndikimi i pandemisë në import;
- Problemet e paraqitura te bizneset gjatë pandemisë dhe
- Problemet/sfidat e bizneseve në vazhdimësi.

Raporti paraqet rezultatet e intervistave gjysmë të strukturuar me ndërmarrjet e industrisë përpunuese të realizuara në periudhën kohore Prill – Maj 2021.

METODOLOGJIA

Për të siguruar informatat sasiore dhe cilësore dhe me qëllim të mbizotërimit të pyetjeve të hapura, është përdorur metodologjia e hulumtimit përmes intervistave gjysmë të strukturuar me ndërmarrjet e industrisë përpunuese.

Metoda e intervistimit ishte e drejtpërdrejt (face to face) dhe është realizuar me përgjegjësit e ndërmarrjeve, me kohëzgjatje rreth 40 minuta.

Nga rreth 4500 ndërmarrje të industrisë përpunuese, janë intervistuar 77 ndërmarrje prej të cilave numri më i madh i tyre, rreth 52 %, janë ndërmarrje të vogla. Fokus i studimit kanë qenë ndërmarrjet me potencial eksportues.

Nga 77 ndërmarrje të vizituara, 13% prej tyre i takojnë sektorit të përpunimit të produkteve ushqimore, 7.8% prodhimit të pijeve, 10.4% ndërmarrje nga tekstili, veshja dhe lëkura, 22% nga prodhimi i drurit, letrës dhe mobileve, 5.2% i produkteve kimike, 16.9% i produkteve të gomës dhe plastikës, 20.8% metaleve dhe produkteve të fabrikuar metalike, 3.9% të industrisë jo metalike.

Përzgjedhja e ndërmarrjeve është kryer në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të komunave përkatëse, në shtatë regjionet e Kosovës, përveç Komunës së Prishtinës ku DPI i ka përzgjedhur vetë bizneset.

Pas realizimit të intervistimit të dhënat sasiore dhe cilësore janë përpunuar dhe analizuar duke përdorur metodën e qasjes së kombinuar.

1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHËME

Pandemia Covid-19, ka shtyrë botën në recesion ekonomik, ku të gjitha vendet kishin rënie në ekonomi dhe vazhdojnë të ballafaqohen me ndikimet ekonomike si pasojë e pandemisë.

Po ashtu edhe në Kosovë, Pandemia Covid-19, ndikoi në shëndetin publik si dhe në masë të madhe ndikoi edhe në ekonominë e vendit dhe si pasojë e rënies së të hyrave si dhe rritjes së shpenzimeve buxhetore deficiti buxhetor i Kosovës ka arritur në 7.1 % e BPV-së¹.

BPV real, në BE ashtu edhe në euro zonë, pritet të arrijë nivelet e para krizës nga mesi i vitit 2022. Sidoqoftë kthimi në nivelin e para krizës të aktivitetit ekonomik do të nënkuptojë akoma rritje të ngadalësuar në ekonominë e BE-së. Industritë prodhuese janë ndikuar nga mungesat afatshkurtra të furnizimit, por shumica e industrive të bazuara në prodhim u rikuperuan relativisht shpejt gjatë tremujorit të tretë (TM 3) të vitit 2020.²

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, “Global Economic Prospects”, BPV-së me çmime të tregut në përqindje, Kosovën e radhitën në vendin e dytë, me rënie në BPV për vitin 2020, pas shtetit të Malit të Zi, krahasuar me vendet e rajonit.

Në Kosovë, pandemia ka atakuar shumë sektorë nga të cilët, përmes vlerës zingjirore, është ndikuar edhe sektori i industrisë përpunuese i cili ka shënuar rënie të lehtë krahasuar me sektorët tjerë. Në përgjithësi të sektorët e industrisë përpunuese është shënuar ulje e kërkesës agregate si rezultat i ndikimit të pandemisë Covid-19. Nëse si shembull marrim sektorin e pijeve, mbyllja e gastronomisë ka ndikuar në uljen e shitjes së pijeve nën 0.50 litra dhe pijeve tjera të cilat kryesisht janë të orientuara në konsum për gastronomi.

Ndër problemet tjera nga pandemia që ka prekur sektorët në vlerë zingjirore është edhe furnizimi me lëndë të parë dhe produkte të gatshme e cila ka ndodhur si pasojë e kufijve të mbyllur dhe vështirësive në transport.

Duke u bazuar në të dhënat e intervistave gjysmë të strukturuar me biznese, sektori i industrisë përpunuese, nga pandemia është goditur kryesisht në pjesën e parë të vitit 2020, deri sa nga tremujori i tretë, ky sektor ka filluar të gjallërohet si dhe t’i kthehet normalitetit.

Ndikimi ekonomik i krizës së Covid-19 nuk është i njëjtë të të gjithë sektorët si edhe te vetë ndërmarrjet brenda një sektori. Ky ndikim varej nga disa faktorë, duke përfshirë mundësinë për t’u përshtatur me ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit, organizimin e funksionimit të ndërmarrjes si dhe shitjet e produkteve.

Projektet parashikuese të Komisionit Evropian janë që ekonomia e BE-së do të zgjerohet me 4.2% në vitin 2021 dhe me 4.4% në vitin 2022. Ekonomia e euro zonës parashihet që të rritet me 4.3% gjatë këtij viti dhe për 4.4% në vitin e ardhshëm.³

¹ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës / Raporti i Stabilitetit Financiar (janar – dhjetor 2020)

² Impacts of the COVID-19 pandemic on EU industries / To contact the Policy Department or to subscribe for email alert updates, please write to: Policy Department for Economic, Scientific and Quality of Life Policies European Parliament L-2929 – Luxembourg.

³ Spring 2021 Economic Forecast: Rolling up sleeves

2. GJETJET KRYESORE

Intervistat e realizuara me nivelin menaxherial të ndërmarrjeve në sektorin e industrisë përpunuese, kanë mundësuar marrjen e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve të cilat janë prezantuar në këtë raport. Përveç të dhënave të përgjithshme të sektorit të industrisë përpunuese, në këtë raport janë pasqyruar edhe të dhënat shtesë për efektet e pandemisë nëpër sektorë.

Sipas intervistave, 53% e ndërmarrjeve deklarojnë se pandemia ka pasur ndikim negativ në bizneset e tyre, 16% deklarojnë se gjatë kohës së pandemisë prodhimi dhe qarkullimi kanë shënuar rritje dhe 31% kanë deklaruar se nuk kanë ndjerë ndikim në biznes si pasojë e pandemisë.


Bazuar në intervistat e përgjithshme të ndërmarrjeve të industrisë përpunuese, ndërmarrjet e sektorit të metaleve dhe produkteve të fabrikua metalike, janë goditur më shumë nga kriza e shkaktuar me Covid-19, ku rreth 75% e ndërmarrjeve të këtij sektori kanë deklaruar se kanë pasur rënie. Përkundër ndikimit negativ në sektorin paraprak, përgjegjësit e 75% të ndërmarrjeve të intervistuar, në sektorin e industrisë kimike, kanë deklaruar se kanë shënuar rritje në prodhim, kryesisht në produktet higjienike.

2.1 Prodhimi

Analiza e të dhënave për ndërmarrjet e intervistuar tregon se gjatë vitit 2020, në procesin e prodhimit nga 77 ndërmarrjet e intervistuar, 55% kanë deklaruar rënie, në 31% të ndërmarrjeve gjendja ka qenë e pa ndryshuar, ndërsa 14% prej tyre kanë deklaruar se kanë shënuar rritje në prodhim, krahasuar me vitin 2019.

Ndërmarrjet e intervistuar, kryesisht kanë qenë mirë të organizuara dhe kanë pasur mundësi që të ruajnë procesin e prodhimit, me gjithat kanë pasur pengesa në zgjerimin e veprimtarisë dhe arritjes së përmbushjes së planit investues dhe prodhues për vitin 2020.


Figura 1. Ndikimi i Covid-19 në prodhim, përgjigjet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Një ndër sektorët e industrisë përpunuese, të përfshira në këtë hulumtim, që është përballur me sfida më të mëdha krahasuar me sektorët tjerë, është sektori i prodhimit të metaleve dhe produkteve të fabrikuar metalike.

Figura 2. Ndikimi i Covid-19 në prodhim sipas sektorëve, përgjigjet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Të dhënat në figurën nr. 2, tregojnë se në hulumtim janë përfshirë 13 nën sektorë të cilët janë fuzionuar në 8 sektorët me prioritet në industrinë përpunuese.

Numri më i madh i ndërmarrjeve prodhuese që kanë deklaruar se kanë pasur rritje janë në sektorin e prodhimit të produkteve kimike, me 75%.

Rënie më të madhe në prodhim kanë deklaruar 75 % e ndërmarrjeve të sektorit të metaleve dhe produkteve të fabrikuar metalike, pastaj 66,67% prodhimi i produkteve të pijeve, 61,54% prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës, 60% e ndërmarrjeve në sektorin e produkteve ushqimore dhe 50% ndërmarrjet në sektorin e produkteve jo metalike.

Gjatë vitit 2020, sipas të dhënave të paraqitura në figurën nr. 2, bazuar në ndërlidhjen e indikatorëve, për ndërmarrjet e intervistuar, qëndrueshmëri në prodhim kanë shënuar 3 sektorë, të cilët janë: sektori i prodhimeve të produkteve kimike, sektori i prodhimit të produkteve nga druri, letra dhe prodhimi i mobileve si dhe sektori i prodhimit të produkteve nga tekstili, veshja dhe produkteve prej lëkure.

Ndër problemet tjera të paraqitura konkretisht në pjesën e parë të vitit 2020, ishte organizimi i procesit të prodhimit, ku ndërmarrjet kanë pasur problem pasi që janë detyruar të punojnë me staf të reduktuar, dhe kjo ka ndikuar në uljen e produktivitetit në procesin e prodhimit.


2.2 Qarkullimi

Duke u nisur nga fakti se pandemia Covid-19, ka prekur të gjitha vendet e botës dhe duke u nisur nga e panjohura, qytetarët kanë hezituuar të shpenzojnë ashtu siç kanë shpenzuar më parë dhe kjo ka ndikuar në rënien e qarkullimit të ndërmarrjeve.

Numri më i madh i ndërmarrjeve në kuadër të sektorit të industrisë prodhuese/përpunuese, të intervistuar, kanë deklaruar rënie në qarkullim, gjë që ka rezultuar në mos realizimin e planeve të tyre.

Sipas figurës nr.3, në vitin 2020, 54.55% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se kanë pasur rënie në qarkullim, 28.57% kanë deklaruar qarkullim të njëjtë dhe 16.88% deklarojnë se kanë pasur rritje në qarkullim, krahasuar me vitin 2019.


Figura 3. Ndikimi i Covid-19 në qarkullim, përgjigjejet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Pjesa e parë e vitit 2020 ishte vit sfidues për ndërmarrjet e sektorit të industrisë përpunuese, e cila ka ndikuar edhe në qarkullim, siç është prezantuar edhe në fig. nr. 4.

Figura 4. Ndikimi i Covid-19 në qarkullim sipas sektorëve, përgjigjejet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Të dhënat në figurën nr. 4, tregojnë se 100% e ndërmarrjeve prodhuese që kanë deklaruar se kanë pasur rritje në qarkullim janë në sektorin e prodhimit të produkteve kimike.

Rënien më të madhe në qarkullim e kanë deklaruar 81.25% e ndërmarrjeve të sektorit të metaleve dhe produkteve të fabrikuara metalike, pastaj 66,67% sektori i produkteve të pijeve, 58,33% sektori i produkteve të gomës dhe plastikës si dhe me nga 50% ndërmarrjet në sektorin e tekstilit, veshjeve dhe produkteve prej lëkure dhe ndërmarrjet në sektorin e produkteve ushqimore.


Gjatë vitit 2020, sipas të dhënave të paraqitura në figurën nr. 4, bazuar në ndërlidhjen e indikatorëve, për ndërmarrjet e intervistuar, qëndrueshmëri në qarkullim kanë shënuar 4 sektorë, të cilët janë: sektori i prodhimit të produkteve kimike, prodhimi i produkteve ushqimore, prodhimi i produkteve jo metalike si dhe sektori i prodhimit të produkteve nga druri e letra dhe prodhimi i mobileve.

2.3 Eksporti

Njëri ndër treguesit me të cilët matet zhvillimi i ndërmarrjes dhe kapacitetet prodhuese është edhe eksporti. Sipas të dhënave të Agjencisë të Statistikave të Kosovës Eksporti në Sektorin C- Industria përpunuese, gjatë vitit ishte 2020 është në vlerë prej 398.46 milion euro, që do të thotë se për nga vlera monetare ka pasur rritje për 106.76 milion euro ose 36.6%, krahasuar me vitin 2019.

Nga të dhënat e përgjithshme të industrisë përpunuese, 16.74% janë ndërmarrje eksportuese, por fokusi i këtij hulumtimi kanë qenë ndërmarrjet eksportuese me pjesëmarrje prej 76.62% ndërsa 23.38% janë ndërmarrje jo-eksportuese, siç tregon edhe Fig. nr. 5.


Figura 5. Ndërmarrjet e intervistuar, eksportuese dhe jo-eksportuese



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Nëse vlerësojmë efektin e pandemisë Covid-19 në performancën e kompanive eksportuese, nga të dhënat e intervistës rezulton se 42.37% e ndërmarrjeve eksportuese kanë deklaruar se kanë pasur rritje, 40.68% kanë deklaruar se kanë pasur rënie dhe 16.95% kanë deklaruar se e kanë ruajtur gjendjen me vitin paraprak.

Figura 6. Ndikimi i Covid-19 në eksport, përgjigjet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar




Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Nga këto të dhëna konkludojmë se vlera e eksporteve të ndërmarrjeve të cilat kanë prezantuar rritje në eksport, gjatë vitit 2020, ka qenë më e lartë se sa vlera e eksporteve të ndërmarrjeve të cilat kanë prezantuar rënie të eksporteve gjatë vitit 2020.

Analiza e të dhënave të hulumtimit të eksportit, sipas sektorëve, tregon se në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, kanë deklaruar rritje në eksport 100% e ndërmarrjeve të intervistuar në sektorin e prodhimit të produkteve kimike. Rritje në eksport kanë deklaruar edhe 66.67% e ndërmarrjeve nga sektori i prodhimit të produkteve ushqimore, pastaj 60% e ndërmarrjeve nga sektori i prodhimit të produkteve të pijeve si dhe 53.85% e ndërmarrjeve të sektorit të prodhimit të produkteve nga druri, letra dhe prodhimi i mobileve.

Numri më i madh i ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar se ka pasur rënie janë në sektorin e prodhimit të metaleve dhe produkteve të fabrikuar metalike me 62.5%. Po ashtu, rënie të theksuar ka shënuar edhe sektori i produkteve të gomës dhe plastikës me 50%.

Figura 7. Ndikimi i Covid-19 në eksport sipas sektorëve, përgjigjejet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Gjatë vitit 2020, sipas të dhënave të paraqitura në figurën nr. 7, bazuar në ndërlidhjen e indikatorëve, për ndërmarrjet e intervistuar, qëndrueshmëri në eksport kanë shënuar 7 sektorë, ndërsa jo qëndrueshmëri ka treguar vetëm sektori i metaleve dhe produkteve të fabrikuar metalike.

Vendet në të cilat kanë eksportuar 76.62% e ndërmarrjeve të intervistuar janë, më së tepërmi në Gjermani pastaj në Zvicër, në Shqipëri, në Maqedoni, në Itali etj.


2.4 Importi

Masat e ndërmarra në gjithë botën, për parandalimin e përhapjes së Covid-19, kanë ndikuar në çrregullimin e tregut dhe furnizimin jo të duhur si në kohë ashtu edhe në sasi.

Pa dyshim se mos funksionimi si duhet i importimit të lëndës së parë, ndikon drejtpërdrejt në procesin e prodhimit. Në rast të krizave të paraqitura, ndërmarrjet në sektorët prodhues duhet të përgatiten që të kenë alternativa të ndryshme të furnizimit.

Të dhënat në Fig. Nr. 8 tregojnë se nga 77 ndërmarrjet e intervistuar 84.4% prej tyre, furnizohen me lëndë të parë nga vendet e jashtme, ndërsa 15.6% furnizohen nga tregu i brendshëm.


Figura 8. Ndërmarrjet e intervistuar, importuese dhe jo-importuese



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Nga 84.4% e ndërmarrje të cilat kanë qenë importues të drejtpërdrejtë, kanë deklaruar se 38.46% e tyre kanë pasur rënie në import, 23.08% rritje dhe 38.46% nuk kanë pasur ndonjë ndryshim.

Figura 9. Ndikimi i Covid-19 në import, përgjigjet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese


Vendet nga të cilat kanë importuar 84.4% e ndërmarrjeve të intervistuar janë nga Turqia, Gjermania, Italia, Serbia, Kina etj.

Bazuar në të dhënat e hulumtimit të importit, sipas figurës nr. 10, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, kanë deklaruar rritje në import 75% e ndërmarrjeve të intervistuar në sektorin e

prodhimit të produkteve kimike. Rritje në import kanë deklaruar edhe 50% e ndërmarrjeve nga sektori i prodhimit të produkteve të pijeve.

Numri më i madh i ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar se ka pasur rënie në import janë në sektorin e prodhimit të metaleve dhe produkteve të fabrikuara metalike dhe në sektorin e prodhimit të produkteve të pijeve, me nga 50%.

Figura 10. Ndikimi i Covid-19 në import sipas sektorëve, përgjigjejet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Gjatë vitit 2020, sipas të dhënave të paraqitura në figurën nr. 10, bazuar në ndërlidhjen e indikatorëve për ndërmarrjet e intervistuar, ka pasur mungesë të importimit/furnizimit me lëndë të parë, si pasojë e Covid-19.

2.5 Punësimi

Ndër problemet kryesore të një vendi është papunësia, e cila mund të shkaktoj apo mund të shëndërrohet edhe në krizë sociale.

Tashmë në vitin 2020, shumë shtete reagueshpejt ndaj krizës së pandemisë, duke rritur fondet për shërbimet e tyre publike të punësimit (SHPP), programe trajnimi dhe masa për të rritur kërkesën për punë.⁴

⁴ [OECD Policy Responses to Coronavirus \(COVID-19\) / Scaling up policies that connect people with jobs in the recovery from COVID-19](#)


Në ndërmarrjet e intervistuar të industrisë përpunuese, largimi i punëtorëve nga puna, nuk është masë e preferuar e ndërmarrjeve edhe përkundër vështirësive të paraqitura. Pavarësisht nga sektorët, 10.39% e ndërmarrjeve të intervistuar, nuk kanë arritur që ta ruajnë numrin e të punësuarve gjatë pandemisë.

Ndër indikatorët tjerë të përgjithshëm, ka qenë edhe identifikimi i të punësuarve në sektorin e industrisë përpunuese sipas gjinisë, ku nga 77 ndërmarrje të intervistuar, 28.87% e të punësuarve janë gra dhe 72.26% janë burra.

Rezultatet e dalura nga intervistimi, tregojnë se sektori i “Prodhimit të produkteve nga tekstilit, veshjet dhe produkteve prej lëkure”, ka të punësuar 83.21% gra, ndërsa 16.79% burra.

Ndër sektorët i cili ka përqindje të ultë të punësimit të grave është sektori “Prodhimi i metaleve dhe produkteve të fabrikuar metalike” me vetëm 3.64%.

Figura 11. Ndikimi i Covid-19 në punësim, përgjigjejet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar




Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Bazuar në të dhënat e hulumtimit të punësimit sipas figurës nr.11, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, në ndërmarrjet e intervistuar, rritje më të madhe në punësim ka deklaruar sektori për prodhimin e produkteve kimike, për 75%.

Numri i ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar se ka pasur rënie në punësim është sektori për prodhimin e produkteve të tekstilit, veshjeve dhe produkteve prej lëkure me 25%.

Figura 12. Ndikimi i Covid-19 në punësim sipas sektorëve, përgjigjetet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese


Gjatë vitit 2020, sipas të dhënave të paraqitura në figurën nr. 12, bazuar në ndërlidhjen e indikatorëve, për ndërmarrjet e intervistuar, shohim se Covid-19 ka ndikuar në rënien e numrit të punësuarve për 10.39%, që do të thotë se 78% e ndërmarrjeve kanë arritur ta ruajnë numrin e punëtorëve, ndërsa rritje kanë shënuar 11.69% e ndërmarrjeve.

Përgjegjësit e ndërmarrjeve të intervistuar kanë deklaruar se për ruajtjen e numrit të punëtorëve, krahasuar me vitin 2019, kanë shfrytëzuar rezervat e tyre buxhetore si dhe masat përkrahëse të ndërmarrja nga Qeveria e Kosovës, përmes pakos emergjente fiskale dhe asaj për rimëkëmbje ekonomike.

2.6 Vlerësimi i masave të ndërmarrja nga qeveria

Vlerësimi i masave nga Pakoja Emergjente Fiskale dhe Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike gjatë vitit 2020, në intervistat me ndërmarrjet të industrisë prodhuese/përpunuese, ka qenë një ndër pyetjet, ku ndërmarrjet kanë ofruar përgjigje nëse kanë pasur, ose jo, efekt nga masat e ndërmarrja nga Qeveria.

Figura 13. Vlerësimi i masave të ndërmarra nga Qeveria, përgjigjet e 77 ndërmarrjeve të intervistuar



Burimi: DPI / të dhënat e përpunuara, bazuar në intervistat e 77 ndërmarrjeve të industrisë përpunuese

Numri më i madh i ndërmarrjeve të intervistuar të industrisë përpunuese, masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për përkrahjen e ndërmarrjeve gjatë kohës së pandemisë, konkretisht gjatë vitit 2020, 55.56% prej tyre, nuk i kanë vlerësuar si të efektshme, si dhe kanë deklaruar se nuk kanë pasur ndikim në qëndrueshmërinë e veprimtarisë së tyre.

Nga figura nr.13, vërehet se 38.10% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se ka pasur pak ndikim, duke mundësuar ruajtjen e vendeve të punës ndërsa 6.35% kanë deklaruar se nuk e kanë pa të arsyeshme që të aplikojnë fare.

Nëse vazhdon pandemia dhe mbyllja në vitin 2021, përgjegjësitë në ndërmarrjet e industrisë përpunuese nuk planifikojnë të ndërrojnë veprimtarinë e tyre, mirëpo do të jenë të detyruar ta reduktojnë numrin e të punësuarve.

3. Sfidat e bizneseve para dhe gjatë pandemisë COVID-19, në përgjithësi

Sfidat e bizneseve të industrisë përpunuese gjatë kohës së pandemisë, në të gjithë sektorët, ishin pothuajse të ngjashëm. Problemi kryesor që është vërejtur gjatë intervistimit me ndërmarrjet, është se numri më i madh i tyre nuk kanë qenë të përgatitura dhe nuk kanë pasur ndonjë strategji se si të veprohet, në rast të ballafaqimit me faktorët e jashtëm siç është pandemia Covid-19.

3.1 Gjatë pandemisë, sfidat kryesore të ndërmarrjeve të intervistuar, kanë qenë:

- Furnizimi me lëndë të parë, sidomos për ndërmarrjet të cilat kanë importuar jashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor;

- Mungesa e mjeteve monetare;
- Vonesat në pagesa;
- Problemet me transport, në përgjithësi;
- Mbyllja e Gastronomisë ka ndikuar në uljen e kërkesës të ndërmarrjet prodhuese;
- Infektimi i punëtorëve nga Covid 19;
- Ndërprerja e linjave të prodhimit.

Problemet apo sfidat e ndërmarrjeve, dallojnë nga sektorët. Sektorët të cilët kanë lidhje me sektorin e ndërtimitarisë, parashohin që problemet, apo krizat financiare të këto ndërmarrje të paraqiten gjatë vitit 2021.

3.2 Sfidat e përgjithshme të paraqitura nga ndërmarrjet e industrisë përpunuese, janë:

- Mungesa e punëtorëve të kualifikuar;
- Mungesa e kontrollit të cilësisë së produkteve të importuara paraqet konkurrencë jo të drejtë në treg;
- Informaliteti i lartë (në prodhim ka shumë biznese të cilat kryejnë prodhimet në shtëpi dhe nuk janë të regjistruara fare, sidomos tekstili dhe produktet nga druri, siç janë mobilieritë);
- Norma e interesit bankar ende është shumë e lartë krahasuar me vendet tjera, po ashtu kthimi i mjeteve fillon menjëherë me rastin e marrjes së kredisë;
- Digjitalizimi i lejeve;
- Ka produkte në treg të cilat nuk e kanë përshkrimin në gjuhën shqipe;
- Problem do të jetë edhe nëse rritet çmimi i rrymës (Kontratat e energjisë duhet të shtyhen sidomos në këtë kohë);
- Vendet tjera sidomos të rajonit, shpesh kërkojnë analiza të ndryshme me qëllim që të paraqesin pengesat e prodhuesve tanë gjatë eksportit të produkteve;
- Rritja e çmimit për lëndën e parë;
- Sfidë për pronarin është neglizhenca e institucioneve lokale dhe qendrore që të bëjë legalizimin e pronave në emër të planit rregullativ të qytetit, por edhe zonave të mbrojtura nga MIA. Janë bërë sfidë e pa kalueshme që si biznese të zgjerohen në pronat personale dhe të rrisin kapacitetin prodhues duke investuar në teknologji të avancuar dhe rritje të punësimit;
- Mungesa e infrastrukturës - hapësira e pa mjaftueshme për punë;
- Problem me sigurimin e vizave – lëvizja e lirë e punëtorëve;
- Mungesa e financave për blerjen e makinerive;
- Kodet Doganore, problem janë mallrat që cilësohen në import, nuk cilësohen njëjtë edhe në Eksport. Por edhe cilësimi i njëjtë, sikur ato që kanë brend, dhe ato me kualitet më të dobët;
- Mungesa e Zonave të Lira Ekonomike;
- Mungesa e Ligjit për lëvizjen e kapitaleve në Kosovë, gjë që vendet si Shqipëria, veç e ka përfunduar vitin e kaluar një ligj të tillë. Ndërsa tek ne ende përgjegjës është BQK.

Ndërmarrjet e intervistuarra, në shumicën e rasteve kanë përmendur problemet financiare. Ndër format më të përshtatshme për ndërmarrjet dolën të jenë, subvencionet dhe garantet dhe kredi bankare me normë të ulët të interesit (1.5 – 3%) dhe kthim afatgjatë të kredisë (10-20 vjet). Problem mjaft i diskutueshëm ishte periudha e kthimit të kredive, apo fillimi i kthimit të kredisë. Ndërmarrjet fillojnë kthimin e kredive në momentin kur e marrin kredinë, deri sa koha më e përshtatshme për fillimin e kthimit të kredive do të ishte periudha pas 1-2 viteve, atëherë kur mund të fillojnë me prodhim dhe shitje.

4. Rekomandimet

1. Të përkrahen ndërmarrjet prodhuese eksportuese, duke subvencionuar eksportin;
2. Krijimi i një skeme financiare, ose të shikohet mundësia e plotësim ndryshimit të Ligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Të shikohet mundësia e shtimit të komponentit për mbulimin ose uljen e normës së interesit si dhe mundësinë e rimbursimit të një përqindje të caktuar (p.sh 15- 30%) të mjeteve që ka investuar në makineri prodhuese ose investim kapital;
3. Të ndërmerren masat stimuluese për rininë me qëllim të mos largimit nga vendi;
4. Të ndërmerren masa për nxitjen e investimeve nga diaspora, në prodhimtari;
5. Zhvillimi i programeve për hulumtimin e tregjeve për eksport si dhe programeve të trajnimeve profesionale për plotësimin e nevojave të tregut;
6. Ndërmarrjet të cilat fillojnë me prodhim të lirohen për 2-3 vite nga tatimet;
7. Të realizohen hulumtime dhe analiza për tregun e punës – me qëllim të harmonizimit të punëdhënësve (sektori privat) dhe punëkërkuësve. Po ashtu, të merren masa për reforma në sistemin e arsimit, duke krijuar dhe forcuar qendrat profesionale dhe të kompetencës;
8. Qeveria duhet të mbështes ndërmarrjet prodhuese që të digjitalizojnë programet e tyre prodhuese, sidomos të ndërmarrjet e mesme, që përafërsisht do të jetë një kosto jo e lartë, nga 30-40 mijë euro investime;
9. Mos të ketë ngritje të çmimit të rrymës (Kontratat e energjisë duhet të shtyhen sidomos në këtë kohë), si dhe propozohet ulja e çmimit të rrymës për industrinë prodhuese;
10. Ndërmarrjet prodhuese eksportuese, të përkrahen me mbulim të interesit për furnizim me lëndë të parë;
11. Mbështetja financiare për praktikantë të rinjë nga ana e Qeverisë.

5. Referencat

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës / Raporti i Stabilitetit Financiar (janar – dhjetor 2020)/ https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2021/04/BQK_FSR_17-1.pdf
2. Impacts of the COVID-19 pandemic on EU industries Impacts of the COVID-19 pandemic on EU industries / [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/662903/IPOL_STU\(2021\)662903_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/662903/IPOL_STU(2021)662903_EN.pdf)
3. World Bank Group / Global economic prospects, January 2021 / <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/34710>
4. Spring 2021 Economic Forecast: Rolling up sleeves / https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/economic-performance-and-forecasts/economic-forecasts/spring-2021-economic-forecast_en
5. Getting Stronger After COVID-19: Nearshoring Potential in the Western Balkans / The Vienna Institute for International Economic Studies/ <https://wiiw.ac.at/getting-stronger-after-covid-19-nearshoring-potential-in-the-western-balkans-dlp-5814.pdf>
6. [OECD Policy Responses to Coronavirus \(COVID-19\)](https://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/scaling-up-policies-that-connect-people-with-jobs-in-the-recovery-from-covid-19-a91d2087/) / Scaling up policies that connect people with jobs in the recovery from COVID-19/ <https://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/scaling-up-policies-that-connect-people-with-jobs-in-the-recovery-from-covid-19-a91d2087/>
7. https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/economic-performance-and-forecasts/economic-forecasts/spring-2021-economic-forecast_en

Aneks 1

Pyetjet e përgjithshme të adresuara gjatë intervistave

1. Informata të Përgjithshme;
2. Ndikimi i COVID-19 në Prodhim;
3. Ndikimi i COVID-19 në Qarkullim;
4. Ndikimi i COVID-19 në Eksport (për ndërmarrjet eksportuese);
5. Ndikimi i COVID-19 në Import (për ndërmarrjet importuese);
6. Ndikimi i COVID-19 në Punësim;
7. Vlerësimi i masave të ndërmarra nga Qeveria;
8. Masat e propozuara nga ndërmarrjet, të cilat mundë të jenë më efektive për ndërmarrjet, nëse do t'i ndërmarrë Qeveria;
9. Sfidat e bizneseve para dhe gjatë pandemisë COVID-19, në përgjithësi;
10. COVID-19 dhe vazhdimësia e biznesit.